

# Ndriçoje Botën me Dashuri

Dhjetor 2021

**K**ëtë Krishtlindje, ndiqe shembullin e Jezu Krishtit për ta ndihmuar dikë që ta ndiejë se e vënë re, e përfshijnë dhe kujdesen për të. Qoftë nëse është një pjesëtar i familjes, një mik, një fqinj, apo dikush që nuk e ke takuar kurrë, së bashku mund të merrni pjesë në nismën #NdriçojeBotën me dashuri.



© 2021 by Intellectual Reserve, Inc. All rights reserved. 101 Albanian.

E DIEL

E HËNË

E MARTË

E MËRKURË

E ENJTE

E PREMTE

E SHTUNË

30

## Jep Falas

Jezusi dha falas. Edhe ne mund të bëjmë po ashtu. Vizito një Makineri për Dhurim pranë teje, ose dhuro kohë apo para për një organizatë bamirësie që bën vepra të mira në zonën tënde. Publiko një hallkë lidhëse në mediat shoqërore që edhe të tjerët të mund të dhurojnë.

1

## Le të Shndritë Dashuria Jote

Jezusi shprehu dashuri për të tjerët. Dërgoju një mesazh me temën "3 gjërat më të mira që më pëlqejnë shumë tek ti" të paktën tre njerëzve. Pastaj etiketoji në mediat shoqërore dhe ftojti të bëjnë të njëjtën gjë.

2

## Dhurata e Njeriut të Mençur

Cili burrë apo grua e mençur e ka bekuar jetën tënde? Tregojë dashurinë dhe vlerësimin tënd.

3

## Krishti Fëmijë

Lindja e Jezusit është për të gjithë. Mblidhu me miqtë ose familjen për të parë materialin filmik *Krishti Fëmijë* në [ndricojeboten.org](http://ndricojeboten.org) (ose shpërndaje hallkën lidhëse në internet).

4

## Duaje të Afërmin Tënd

Jezusi na mësoi përkufizimin e vërtetë të dashurisë për të afërmin. Bashkëbisedo me një fqinj/e që nuk e njeh mirë.

5

## Ndihmë nga Agjërimi

Mos konsumo një ose dy vakte dhe dhuroja koston e atyre vakteve të pangrëna një organizatë bamirësie që ushqen njerëzit në nevojë. Mëso më shumë për bekimet e agjëritit - kërkoni një takim me misionarët në [ndricojeboten.org](http://ndricojeboten.org).

6

## Kujtesa Magjike

Gjej një fotografi të një kujtimi të veçantë Krishtlindjeje që ke pasur me një shok/shoqe ose pjesëtar/e të familjes. Tregojta atë njeriut tënd të dashur bashkë me një mesazh se përse është i/e rëndësishëm/me për ty.

7

## Kujdes për Shëndetin

Shpreh dashuri për dikë që u kujdes për ty ose për një pjesëtar të familjes vitin e kaluar.

8

## Vëmendje e Plotë

Jezusi i deshi njerëzit aq sa t'u kushtonte vëmendjen e Tij të plotë. Sot, zotohu që të mos merresh me telefonin kurdoherë që dikush të flet.

9

## Ndize Pemën Familjare

Nderoju ata që erdhën para teje. Gjej pak kohë sot për të mësuar për një paraardhës/e. Telefonoji një gjysh/i/e ose provo një mjet për historinë familjare si [familysearch.org/sq/](http://familysearch.org/sq/) dhe tregojta të afërmeve atë që ke gjetur.

10

## Koha e Shfaqjes

Jezusi pati një mënyrë mahnitëse për t'i bërë të tjerët të ndiheshin të përfshirë. Gjej një koncert, shfaqje ose ngjarje tjetër për Krishtlindje në zonën tënde dhe ftojti dikë që të marrë pjesë bashkë me ty.

11

## Receta Gatimi për t'u Gëzuar

Jezusi u lidh me njerëz të tjerë gjatë vakteve ushqimore të përbashkëta. Mëso se si të përgatisësh një recetë tradicionale Krishtlindje nga një pjesë e veçantë e botës. Pastaj ndaje atë me miqtë ose familjarët.

12

## Ruaj një Ndenjëse

Shpërndaje gëzimin nga lindja e Krishtit. Ftojti një mik ose pjesëtar të familjes që të ndjekë një shërbim adhurimi për Krishtlindje bashkë me ty të dielën tjetër, më 19 dhjetor. Vizito faqen [ndricojeboten.org](http://ndricojeboten.org) për të gjetur një godinë kishitare pranë teje.

13

## Dhurata e Lutjes

Sot, gjunjëzohu dhe bëji një lutje Perëndisë. Vëre synim të lutesh çdo mëngjes këtë javë. A ke nevojë për pak ndihmë për ta filluar? Mund të mësosh më shumë se si të lutesh te [Become.org](http://Become.org).

14

## Përhëndetjet gjatë Periudhës së Krishtlindjes

Jezusi iu afrua njerëzve rreth e rrotull Tij. Përhëndete sot dikë që nuk e ke përhëndetur më parë.

15

## Ylli Shndritës

Përkushtoja yllin në pemën tënde dikujt që ishte një dritë në jetën tënde këtë vit. Bëj një fotografi dhe publikoje atë në mediat shoqërore së bashku me një mesazh për mënyrën se si ai person ka ndikuar tek ti.

16

## Darkat për Krishtlindje

Ashtu si Jezusi, ti mund të ushqesh të uriturit. Çoji ushqim dikujt që mund ta përdorë ose krijo një paketë dhurimi për një bankë vendore ushqimesh. Rekruto një shok/shoqe për të të ndihmuar.

17

## Bari i Fshehtë

Kush ka qenë një bari për ty, duke të udhëhequr me dashuri gjatë jetës? Nxirre në pah atë në mënyrë private ose publike.

18

## Këngë që ia Vlen t'i Shpërndajmë

Përfjetoje fuqinë e muzikës së shenjtë - qoftë duke kënduar me njerëzit e dashur, duke kënduar këngë Krishtlindjeje për fqinjët ose duke shpërndarë në rrjetin tënd shoqëror një shfaqje të himnit tënd të parapelqyer.

19

## Nga Lluka 2 tek Ti

Kujtohu për arsyen e vërtetë të kësaj periudhe duke lexuar disa fragmente të historisë së Krishtlindjes nga Lluka 2 në Biblën e Shenjtë. Vizito [ndricojeboten.org](http://ndricojeboten.org) për të dëgjuar një mesazh Krishtlindjeje nga misionarët tanë.

20

## Koha me Njëri-Tjetrin

Këtë Krishtlindje, rrethoju me njerëzit e tu të dashur. Fto sa më shumë pjesëtarë të familjes që të mundesh për t'u mbledhur së bashku për një takim virtual.

21

## Shpërndaje Dritën

Ashtu si Jezusi, ti mund të japësh mësim nëpërmjet historive. Tregojta në rrjetin tënd shoqëror një histori frymëzuese nga jeta jote që mund ta ndihmojë dikë.

22

## Dhuratat nga Perëndia

Ti mund të shprehësh mirënjohje siç bëri Jezusi. Reflektoj për dhuratat që të ka dhënë Perëndia, dhe shkruaji ato. Tregojta të tjerëve mirënjohjen tënde.

23

## Qeras Dy Herë

Ktheje një veprim të mirë në dy. Bëj dy pjata me ushqime. Jepja njërin një shoku/shoqje; tjetrën jepja dikujt që të sugjeroi shoku/shoqa.

24

## Duaji Mamin dhe Babin

Ji si Jezusi dhe shprehe dashurinë për prindërit e tu (ose një figurë prindërore në jetën tënde). Merrni në telefon, vizitoji ata ose publiko varje nga Bibla: Gjoni 3:16; Veprat e Apostujve 4:10-12.

25

## Jezusi Është Drita e Botës

Shpërnda një shkrim të shenjtë që mendon se e tregon arsyen e periudhës së Krishtlindjes. A ke nevojë për disa sugjerime? Shihni këto varje nga Bibla: Gjoni 3:16; Veprat e Apostujve 4:10-12.

26

Ndriçoje Vitin 2022

Vazhdo ta shpërndash dashurinë e Jezu Krishtit. Shndërroje sfidën për pjesëmarrje në nismën #NdriçojeBotën për çdo ditë në një synim për Vitin e Ri. Mos u druaj që ta shpërndash synimin tënd në rrjetin tënd shoqëror.